



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimeve në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 609, datë 27.7.2020 “Disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar, Urdhërit të Ministrit Nr. 103 datë 26.2.2021” Mbi procedurën e konkursit për punonjësit me kontratë”, shpall njoftimin për vende të lira pune në pozicionet:

- **5 veterinerë zyrtarë të shërbimit**, pranë Agjencisë së Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Tiranë;
- **19 veterinerë zyrtarë të shërbimit**, pranë Agjencisë së Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Shkodër;
- **34 veterinerë zyrtarë të shërbimit**, pranë Agjencisë së Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Elbasan;
- **27 veterinerë zyrtarë të shërbimit**, pranë Agjencisë së Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Vlorë;

Detyrat kryesore për vendet e shpallura janë:

- Identifikimin dhe regjistrimin e fermës e të kafshëve blegtorale dhe lëshimin e certifikatës veterinare të lëvizjes së kafshëve, sipas rregullores përkatëse;
- Zbatimin praktik të programeve të profilaksisë shtetërore për sëmundjet në kafshë në një ose disa njësi administrative të përcaktuara; zbatimin e masave për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, në vatrat e shpërthimeve.
- Në rastet e sëmundjeve zoonotike, veterineri zyrtar i shërbimit informon strukturat përkatëse të shëndetit publik dhe institucionin përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Kandidatet duhet të dorëzojnë:

- kërkesën për punësim, ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë;
- një kopje të CV-së të përditësuar;
- diplomën “Mjek Veteriner” të noterizuar;
- certifikata me kualifikime të ndryshme;
- një kopje të librezës së punës;
- një kopje të ID-së;
- formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore (*dëshmi penaliteti*);
- raportin mjeko - ligjor (*për personat që do të përzgjidhen fitues*).

Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet në adresën e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve ku kandidati do të aplikojë për punësim.

Dorëzimi i dokumentacionit përbën kusht për kualifikimin e kandidatit në procedurë.

Kërkesat e protokolluara nga kandidatët e interesuar do të pranohen nga data 30.4.2021 deri më datë 10.05 .2021.

Pas përfundimit të përzgjedhjes së kandidatëve fitues do të bëhet njoftimi për intervistën e strukturuar me gojë.

AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMEVE

Drejtor i Përgjithshëm

Tana Kika

